



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
10.06.2015, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP-të LDK-së, Hazir Borovci, anëtar i LDK-së, Besa Rafuna anëtare e LDK-së, Qëndron Kastrati shef i GP-të të LVV, Hatixhe Hoxha anëtare e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Saranda Bogujevci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rabbit Krasniqi, përfaqësuesi nga OSBE-ja, si dhe përfaqësuese të mediave dhe Shoqërisë Civile.

Mbledhjen e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj**, paraqiti qëndrimin e PDK-së, që pikat të cilat kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit, të mos diskutohen dhe të mos votohen. Bazuar në këtë, ai propozoi që pikat e rendit të ditës (sipas rendit të ditës të propozuar), pika e tretë - Propozimvendimi për miratimin - lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria"; pika e katërt - Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1", të hiqen nga rendi i ditës, ndërsa pika e pestë - Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes

“Lakërishtë “në Prishtinë, kjo çështje mund të zgjidhet nga drejtoria pa ardhur në Kuvend.

Po ashtu z. **Çelaj**, shprehu edhe një ankesë që iu është adresuar atij nga një personi që ka organizuar paradën kundër homofobisë, që sipas tij është fyer nga një zyrtarë i komunës dhe mendon se ju është shkelur e drejta e tyre.

Dardan Sejdiu tha se ankesa është bërë dhe kanë kërkuar nga ankuesi që të jepet emri i personit zyrtar që pretendohet që fyer atë dhe të ndërmerren masa ndaj tij.

Sami Hamiti tha se pajtohet me z. **Çelaj**, që pikat që lidhen me drejtorin e Urbanizmit të mos shkojnë, të mos diskutohen ndërsa për pikat tjera është që të shkojnë për tu aprovuar në Kuvend.

Kryesuesi propozoi që të shkojnë këto tri pika për në Kuvend dhe më pas në Kuvend të vendoset a të diskutohet dhe merret vendim lidhur me këto pika.

Nga anëtarët e KPF-së, u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;
2. Prezantim i shkurtër lidhur me punën dhe aktivitetet – Kryqi i Kuq i Kosovës;
3. Propozimvendimi për miratimin -lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes “Kalabria”;
4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes “Mati 1”;
5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes “Lakërishta” në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;
8. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së;
9. Informatë për gjendjen në institucionet e kulturës;
10. Informatë për bibliotekën “Hivzi Sylejmani” në Prishtinë;
11. Informatë për mbjellje pranverore;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Kryesuesi konstatoi se me një abstenim (Qëndron Kastrati) u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të KPF-së.

Pika e dytë

Prezantim i shkurtër lidhur me punën dhe aktivitetet – Kryqi i Kuq i Kosovës;

Kryesuesi tha në mbledhjen e Kuvendit do të marrin pjesë përfaqësues të Kryqit të Kuq të Kosovës, të cilët do ta bëjnë këtë prezantim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah prezantimi i shkurtër lidhur me punën dhe aktivitetet – Kryqi i Kuq i Kosovës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin -lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";

Pika e katërt

Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1";

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;

Pasi që **Kryesuesi** propozoi që të shkojnë këto tri pika, pra pika e tretë, katërt dhe pestë për në Kuvend dhe më pas në Kuvend të vendoset a të diskutohet dhe merret vendim lidhur me këto pika, ashtu edhe u aprovuan nga anëtarët e KPF-së.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, informoi drejtori i drejtorisë për Financa dhe Pronë **Visar Berisha**, i cili sqaroi se është fjala për dhënien në shfrytëzim të disa pronave të paluajtshme të Komunës në fshatin Barilevë.

Z. Berisha tregoi se qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme është nxitja e zhvillimit ekonomik, përmes zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Prishtinës, afati kohor për dhënien në shfrytëzim është afatshkurtër, në periudhën prej 15 viteve.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, informoi drejtori i drejtorisë për Financa dhe Pronë **Visar Berisha**. Në këtë rast tregoi se bëhët fjalë për dhënien në shfrytëzim të pesë pronave të paluajtshme të Komunës në fshatin Barilevë.

Përseri z. Berisha arsyetoi propozimin e kësaj pika, duke thënë se qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme është nxitja e zhvillimit ekonomik, përmes zhvillimit të industrisë së prodhimit dhe përpunimit në Komunën e Prishtinës, afati kohor për dhënien në shfrytëzim është afatgjatë në periudhën prej 40 viteve.

Procedurat për dhënien e pronave në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes konkursit publik.

Kryesuesi shprehi interesim pse në rastin e parë e kemi dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në afat kohor pre 15 viteve e në rastin e dytë prej 40 viteve.

Z. Berisha i dha sqarime kryesuesit në pyetjen e lartë përmendur.

Sami Hamiti kërkoi që për mbledhje të Kuvendit të përgatiten arsyetimet me të dhëna më të gjëra dhe të specifikuar si për Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

Qëndron Kastrati tha se e mbështesin ndihmesën e Komunës si në aspektin e bujqësisë po ashtu edhe të zhvillimit ekonomik, përmes zhvillimit të industrisë së prodhimit.

Ai parashtroi pyetjen se a ka nevojë çështja e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, në afat prej 15 viteve të miratohet nga Kuvendi Komunal?

Imer Rusinovci tha se i përkrahin këto dy propozimvendime, mirëpo për Kuvend të jenë arsyetimet më të gjëra dhe të konsultohen me Ministrinë e Bujqësisë.

Lirak Çelaj tha se janë për këto dy propozimvendime, mirëpo për Kuvend të specifikohen.

Visar Berisha tha sa i përket pyetjes së z. Kastrati si në propozimvendimin e parë po ashtu edhe në propozimvendimin e dytë duhet të shkojnë në Kuvend Komunal.

Sa i përket arsyetimeve për Kuvend do të jenë më të specifikuar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe Propozimvendimi për dhënien e

pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-ut;

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së , Visar Berisha tha se është kërkesë e Ministrisë që t'i vazhdohet AUK-ut kontrata për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës edhe për 10 vite. Ai tha se materialin nuk është përgatitur, mirëpo për mbledhje të Kuvendit do të finalizohet.

Sami Hamiti tha se e përkrahin këtë propozimvendim.

Qëndron Kastrati propozoi që Komuna të kërkon nga AUK-u që disa kategorive të studentëve t'i ndihmohet për të vazhduar aty shkollimin me bursa etj.

Lirak Çelaj tha se janë për që të vazhdohet edhe për një periudhë kjo kontratë.

Kryesuesi propozoi që në vendimin e përgatitur për Kuvend të ceket se a ipet me pagesa apo jo në shfrytëzim prona.

Lirak Çelaj tha se është që të mos i ipet pa pagesë (jo fitimprurës) prona në shfrytëzim ose me bërë me kompenzim me bursa etj.

Imer Rusinovci pajtohet se duhet t'i vazhdohet kontrata AUK-ut.

Dardan Sejdiu tha se AUK-u është organizatë jo fitimprurëse, mirëpo e çmon se ka bërë shumë për Kosovën, i ka shtuar vlerën shumë Kosovës si në arsim, kulturë etj.

Ndërsa, sa i përket Spitalit Amerikan tha se kanë pasur takim dhe do të jetë gjithçka sipas kontratës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-ut dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Informatë për gjendjen në institucionet e kulturës;

Lidhur me Informatën për gjendjen në institucionet e kulturës, informoi drejtorja e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Saranda Bogujevci e cila tregoi në detaje se çfarë përmban informata dhe sqaroi se materiali është përgatitur më herët, mirëpo do të plotësohet ky materiali për Kuvend.

Pika e dhjetë

Informatë për bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë;

Lidhur me Informatën për bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë, informoi drejtorja e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Saranda Bogujevci e cila tregoi se në bibliotekë janë bërë disa renovime dhe ka probleme me rrjedhjen e ujit, mirëpo do të vazhdojnë punimet për rregullimin e tij. Po ashtu tregoi se në Arkiv kanë përfunduar renovimet me muret e objektit.

Dardan Sejdiu tha se dokumenti do të përpunohet më mirë për Kuvend.

Qëndron Kastrati tha se kanë kërkuar disa herë që të jetë si pikë e rendit të ditës Raporti për Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" të dihet ku qëndrojnë problemet.

Lirak Çelaj tha se këto materiale nuk i ngjasojnë aspak raporteve të kulturës. Andaj sugjeroi që informata të jetë më e analizuar.

Ai propozoi që renovimeve që janë bërë të iu bëhet një auditim për atë punë që është punuare. Po ashtu sugjeroi që të parashihen disa vija buxhetore për teatrin "Dodona".

Dardan Sejdiu tha se materiali duhet të plotësohet e të shkoj për kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrahen Informata për gjendjen në institucionet e kulturës dhe Informatën për bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë që të përpunohet materiali e të shkoj për Kuvend.

Pika e njëmbëdhjetë

Informatë për mbjellje pranverore;

Dardan Sejdiu tha sa i përket kësaj informate materialin e keni dhe në Kuvend do të informoheni.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah, Informatë për mbjellje pranverore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.